



# PLANI STRATEGJIK PËR PERIUDHËN 2025-2029

**FUQIZIMI I SKEMËS  
SË SIGURIMIT TË  
DEPOZITAVE NË  
MBËSHTETJE TË  
STABILITETIT  
FINANCIAR**

---

# TABELA E PËRMBATJES

<b>AKRONIMET</b>	<b>6</b>
<b>SISTEMI I SIGURIMIT TË DEPOZITAVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS</b>	<b>9</b>
<b>FONDI I SIGURIMIT TË DEPOZITAVE NË KOSOVË</b>	<b>11</b>
<b>PLANI STRATEGJIK 2025-2029</b>	<b>13</b>
<b>Qëllimet, objektivat dhe iniciativat strategjike</b>	<b>14</b>
<b>QËLLIMI 1: AVANCIMI I FINANCIMIT PËR SISTEMIN E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE</b>	<b>15</b>
<b>QËLLIMI 2: RRRITJA E GATISHMËRISË OPERACIONALE PËR PROCES TË KOMPENZIMIT EFEKTIV DHE TË SHPEJTË</b>	<b>19</b>
<b>QËLLIMI 3: NGRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE, DIGJITALIZIMI DHE MODERNIZIMI I PROCESIVE</b>	<b>23</b>
<b>QËLLIMI 4: HARMONIZIMI I LEGJISLACIONIT TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE ME DIREKTIVAT EVROPIANE</b>	<b>27</b>
<b>QËLLIMI 5: FUQIZIMI I RAPORTEVE NDËRINSTITUCIONALE DHE BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR</b>	<b>29</b>

# AKRONIMET

<b>BQK</b>	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
<b>MF</b>	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
<b>BM</b>	Bordi Menaxhues
<b>DM</b>	Drejtori Menaxhues
<b>SKD</b>	Sistemi për Kompenzim të Depozitorëve
<b>FSD</b>	Fondi i Sigurimit të Depozitave
<b>FSDK</b>	Fondi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë
<b>SSD</b>	Sistemi i Sigurimit të Depozitave
<b>EFDI</b>	Forumi Evropian i Siguruesve të Depozitave
<b>IADI</b>	Shoqata Ndërkombëtare e Siguruesve të Depozitave
<b>SHBK</b>	Shoqata e Bankave të Kosovës
<b>LSD</b>	Ligji Nr.03/L- 216 Mbi Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë, dhe Ligji Nr.04 / L-133 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03 / L-216 Mbi Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë
<b>PARIMET THEMELORE</b>	Parimet Themelore për Sisteme efektive të Sigurimit të Depozitave, të publikuara nga Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare dhe IADI
<b>BAP</b>	Banka Agjente për Pagesë

## Të nderuar lexues,

Kemi kënaqësinë që të prezantojmë Planin Strategjik për periudhën 2025–2029 të Fondit të Sigurimit të Depozitave në Kosovë (FSDK). Ky Plan Strategjik reflekton vizionin tonë të përbashkët për avancimin e sistemit të sigurimit të depozitave që do të kontribuojë në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar të Republikës së Kosovës me mbështetjen e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Plani Strategjik për periudhën 2025–2029 ndërtohet mbi themele të forta, duke përcaktuar një vizion me prioritet dhe objektiva të qarta strategjike. Ky plan është një dëshmi e përkushtimit tonë të vazhdueshëm për mbrojtjen e depozitorëve dhe fuqizimin e sektorit financiar duke synuar rritjen e qëndrueshmërisë dhe stabilitetin në mbështetje të ekonomisë së Republikës së Kosovës.

Plani Strategjik për periudhën 2025–2029 është përqendruar në pesë shtylla kryesore të zhvillimit institucional të FSDK-së si dhe fuqizimin e sistemit të sigurimit të depozitave në Republikën e Kosovës:

- 1 Fuqizimi i mekanizmit të financimit:** Avancimi i mekanizmit të brendshëm të financimit me implementimin e sistemit të ri të premiumeve për bankat anëtare si dhe krijimi i mekanizmit të jashtëm të financimit të likuiditetit për përmbushje efektive të mandatit për kompenzim të shpejtë të depozitorëve të siguruar për të kontribuar në stabilitetin financiar.
- 2 Rritja e Gatishmërisë Operacionale:** Avancimi i sistemeve dhe proceseve për të rritur gatishmërinë operacionale në përmbushjen e mandatit të FSDK-së për kompenzimin efektiv dhe të shpejtë të depozitorëve të siguruar në rast të ngjarjes së siguruar.
- 3 Transformimi digjital dhe modernizimi i proceseve:** Modernizimi i infrastrukturës dhe sistemeve duke adaptuar teknologjitë e reja për të përmbushur standardet e industrisë së teknologjisë informative dhe sigurisë së informacionit me fokus në sigurinë kibernetike.

- 4 Harmonizimi i Kornizës Ligjore me Direktivat e BE-së:** Harmonizimi i Ligjit të Sigurimit të Depozitave me Direktivën e Bashkimit Evropian për Skemat e Sigurimit të Depozitave dhe legjislacionin e BE-së për Rimëkëmbjen dhe Përmbylljen e Bankave. Harmonizimi i legjislacionit të FSDK-së me Direktivat e BE përveç se do të përafrojë legjislacionin do të kontribuojë edhe në fuqizimin e mëtejshëm të sistemit të sigurimit të depozitave.

- 5 Fuqizimi i bashkëpunimit ndër-institucional dhe ndërkombëtar:** Ndërtimi i partneriteteve brenda dhe jashtë vendit për të forcuar sistemin e sigurimit të depozitave dhe rritjen e sigurisë financiare të Republikës së Kosovës.

Plani i ri Strategjik për periudhën në vijim i ofron FSDK-së një vizion të qartë në arritjen e qëllimeve dhe objektivave strategjike për avancimet e mëtejshme në nivel të zhvillimit institucional si dhe fuqizimin e sistemit të sigurimit të depozitave. Ndërsa Kosova aspirojnë drejt integritet në BE dhe zhvillimit ekonomik, FSDK mbetet e palëkundur në misionin e saj për të mbrojtur depozitorët dhe për të kontribuar në një mjedis financiar të qëndrueshëm.

Ne shprehim mirënjohjen tonë ndaj Bordit Menaxhues, ekipit tonë në FSDK dhe të gjithë palëve të interesit që kanë kontribuar në zhvillimin e këtij vizioni strategjik. Së bashku, punojmë për të ndërtuar një sistem të sigurimit të depozitave më të avancuar dhe më të qëndrueshëm, që i shërben interesave më të mira të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Me nderime,

**Ahmet Ismaili**  
Kryesues i Bordit Menaxhues

**Shqipe Devaja**  
Drejtoreshë Menaxhuese



### VIZIONI

Akter i rëndësishëm i rrjetit të sigurisë financiare i bazuar në standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare në fushën e sigurimit të depozitave.



### MISIONI

Kompenzim efektiv dhe të shpejtë të depozitorëve për të kontribuar në mbështetjen e BQK në ruajtjen e stabilitetit financiar dhe rritjen e besimit në sistemin bankar në Republikën e Kosovës.



### VLERAT INSTITUCIONALE

Integriteti dhe Etika  
Kompetenca dhe Profesionalizmi  
Inovacionet dhe Reformat  
Transparenca dhe Llogaridhënia  
Efektiviteti dhe Efikasiteti  
Cilësia dhe Përkushtimi

# SISTEMI I SIGURIMIT TË DEPOZITAVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

## Sistemi i sigurimit të depozitave në Republikën e Kosovës

Sistemi i sigurimit të depozitave ('SSD') i referohet siguresit të depozitave dhe raporteve me pjesëmarrësit e rrjetit të sigurisë financiare në mbështetje të mandatit të sigurimit të depozitave kompenzimit të depozitorëve në rast të ngjarjes së siguruar dhe pjesëmarrjes me fonde në proces të përmbylljes së bankës për të mbështetur stabilitetin financiar.

Një SSD efektive është një shtyllë e rëndësishme e rrjetit të sigurisë financiare dhe luan rol kyç në sigurimin e stabilitetit të sistemit financiar dhe kompenzimin e depozitorëve. Sistemi për Sigurimin e Depozitave mbikëqyret nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK).

Sistemi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë është themeluar në vitin 2011 në bazë të Ligjit mbi Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë (tutje: LSD). Objektivat primare të këtij sistemi janë mbrojtja e depozitorëve dhe ofrimi i kontributit në sigurimin e stabilitetit financiar.



**FONDI I SIGURIMIT  
TË DEPOZITAVE  
NË KOSOVË**

## Fondi i sigurimit të depozitave në Kosovë

Fondi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë (FSDK) është institucion i pavarur publik i themeluar në vitin 2011 në bazë të LSD-së.

FSDK si institucion i pavarur ka autonomi operacionale, financiare dhe administrative nga strukturat e qeverisë dhe shërbimit civil në Kosovë dhe është e liruar nga tatimi mbi të ardhurat e korporatave.

Mandati kryesor i FSDK-së është sigurimi dhe kompensimi i depozitave të personave fizik dhe juridik në çdo institucion anëtar të FSDK-së dhe kompensimi i depozitorëve të siguar deri në limitin e sigurimit të përcaktuar me ligj brenda tridhjetë (30) ditëve në rast të revokimit të licencës së bankës nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. FSDK menaxhon Fondin për Sigurimin e Depozitave ('FSD') që shfrytëzohet vetëm për qëllim të kompensimit të depozitorëve të siguar në rast të një ngjarje të siguar, dhe për financimin e shpenzimeve operacionale të FSDK-së. Financimi kryesor i FSD-së sigurohet përmes arkëtimit të premieeve fillestare dhe të vazhdueshme të sigurimit të depozitave nga bankat anëtare.

Sipas LSD-së, FSDK i raporton Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në baza vjetore. Sipas LSD-së, FSDK-ja qeveriset nga Bordi Menaxhues dhe menaxhohet nga Drejtori Menaxhues.

Për të përmbushur mandatin e përcaktuar me ligj si dhe rolin dhe përgjegjësitë e saj, FSDK ndër të tjera ka autoritet si në vijim:


- 1 Përcaktojë nivelin dhe arkëtimin e premieeve për sigurimin e depozitave;
- 2 Investojë drejtpërdrejtë apo përmes delegimit të autoritetit të aset menaxherët për menaxhimin e pasurive të Fondit për Sigurimin e Depozitave.
- 3 Kompensimi i depozitorëve të siguar sipas dispozitave të LSD.
- 4 Bashkëpunojë me Bankën Qendrore të Kosovës në shkëmbimin e informacionit;
- 5 Në bashkëpunim me BQK, të marrë pjesë me fonde, në procesin e përmbylljes së bankës
- 6 Marrë fonde hua në rast të pamjaftueshmërisë së fondeve me përjashtim të institucioneve të bankave anëtare;
- 7 Miratimi i legjislacionit sekondar dhe
- 8 Aplikimi i sanksioneve administrative

# Plani strategjik 2025-2029

## Qëllimet, objektivat dhe iniciativat strategjike

Plani strategjik përfshin periudhën pesë vjeçare duke përcaktuar qëllimet, objektivat dhe iniciativat strategjike për fuqizimin e sistemit të sigurimit të depozitave në funksion të mbrojtjes së depozitorëve si dhe mbështetjen e BQK-së në ruajtjen e stabilitetit financiar.

Figura 1. Qëllimet Strategjike 2025-2029



# QËLLIMI 1: AVANCIMI I FINANCIMIT PËR SISTEMIN E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

# Qëllimi 1: Avancimi i financimit për sistemin e sigurimit të depozitave

**Objektivi: Implementimi i sistemit për premiumet e bazuar në rrezik sipas Udhëzimeve të Autoritetit Bankar Evropian (EBA)**

Harmonizimi me Direktivën e BE-së për Skemat e Sigurimit të Depozitave (EU DGSD) dhe Udhëzimet e Autoritetit Bankar Evropian (EBA) mbi kontributet e bazuara në rrezik për skemat e sigurimit të depozitave. FSDK synon me këtë reformë të avancojë sistemin e saj të premiumeve bazuar në praktikatat më të mira të BE-së për një sistem efektiv të sigurimit të depozitave. Sistemi i ri i premiumeve do të përmirësojë ndjeshëm kapacitetin e FSDK-së për të vlerësuar profilin e rrezikut të bankave anëtare me qëllim të llogaritjes së premiumeve dhe vlerësimit të ekspozimit të përgjithshëm ndaj bankave anëtare, duke kontribuar kështu në rritjen e konfidencës në skemën e sigurimit të depozitave dhe stabilitetin e sistemit financiar.

- Fillimi i implementimit të sistemit të ri për premiumet e bazuara në rrezik
- Implementimi i rregullores për premiumet e bazuara në rrezik për bankat anëtare
- Trajnimi i bankave anëtare për implementim efektiv të sistemit të ri të premiumeve të bazuara në rrezik nga bankat anëtare
- Monitorimi i efektivitetit pas zbatimit të implementimit të sistemit të ri të premiumeve të bazuara në rrezik nga bankat anëtare
- Kalibrimi i modelit nëpërmjet analizës statistikore të analizës së serive kohore

**Objektivi: Sigurimi i fondeve rezervë për financimin e likuiditetit**

Parimet Themelore të IADI-it për Sisteme Efektive të Sigurimit të Depozitave mbi Burimet dhe Përdorimet e Fondeve, rekomandojnë që siguroesi i depozitave duhet të ketë fonde të disponueshme dhe të gjithë mekanizmat e financimit, duke përfshirë financimin rezervë të likuiditetit të siguruar.

- Sigurimi i financimit nga Ministria e Financave nëpërmes Bankës Botërore në kuadër të Projektit për Zhvillimin e Sektorit Financiar për rritjen e limitit të sigurimit të depozitave.
- Sigurimi i garancionit shtetëror nga Qeveria përmes Ministrisë së Financave për linja kreditore nga sektori privat me Institucionet Financiare Ndërkombëtare
  - Shuma e linjave të kredisë: Diskutim teknik me Ministrinë e Financave për përcaktimin e shumës së linjave të kredisë
  - Lëshimi i garancisë shtetërore: Diskutime teknike me Ministrinë e Financave për lëshimin e garancionit shtetëror për të mbështetur sigurimin e shumës së linjave të kredisë përmes sektorit privat nëpërmjet institucioneve financiare ndërkombëtare
  - Sigurimi i linjave të kredisë: Finalizimi i marrëveshjeve të financimit me kreditorët për linjat e kreditit
- Krijimi i mekanizmit të përhershëm për financimin e likuiditetit me Thesarin e Shtetit bazuar në praktikatat më të mira ndërkombëtare

- Negocimi dhe Marrëveshja: Diskutime teknike me Thesarin e Shtetit për të vendosur termat dhe kushtet për mekanizmin e përhershëm të financimit të likuiditetit.
- Marrëveshja e financimit: Hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjes financiare për krijimin e mekanizmit të përhershëm të financimit të likuiditetit.
- Implementimi: Krijimi i procedurave operacionale për aksesin në mekanizmin e përhershëm të financimit të likuiditetit.
- Studimi i mundësisë së emetimit të letrave me vlerë me mbështetjen e Bankës Qendrore
  - Studimi i Fizibilitetit: Studim gjithëpërfshirës për të vlerësuar mundësinë e emetimit të letrave me vlerë
  - Mbështetja e Bankës Qendrore: Diskutime teknike me Bankën Qendrore për të kuptuar kërkesat rregullatore dhe mekanizmat mbështetës për emetimin e letrave me vlerë
  - Analiza e tregut: Analiza e çmimit të tregut për të përcaktuar kohën dhe strukturën optimale për emetimin e letrave me vlerë
- Draftimi i kornizës rregullative për emetimin e letrave me vlerë si mekanizëm shtesë financimi të jashtëm
  - Analiza e legjislacionit: Rishikimi i rregulloreve ekzistuese për emetimin e letrave me vlerë nga institucionet e pavarura si FSDK
  - Draftimi i rregulloreve të reja, duke përfshirë praktikatat më të mira nga juridiksione të tjera

**Objektivi: Funkcionalizimi i kornizës së kontributit me fonde në përmbylljen e bankës**

FSDK synon të hartojë rregulloren e re për pjesëmarrjen e FSDK-së me financim në proces të përmbylljes të bankës anëtare nga autoriteti përmbyllës bazuar në Ligjin për Sigurimin e Depozitave. Më tej, zhvillimi i modeleve financiare për vlerësimin e pjesëmarrjes së FSDK-së me fonde në proces të përmbylljes të bankës anëtare për opsionet me kosto më efektive për fondin e sigurimit të depozitave.

- Draftimi i rregullores për pjesëmarrjen me fonde të FSDK-së në procesin e përmbylljes së bankave anëtare bazuar në ligjin e ri për bankat dhe ligjin për sigurimin e depozitave;
- Zhvillimi i modeleve financiare për vlerësimin e pjesëmarrjes së FSDK-së me fonde në procesin e përmbylljes së bankave.

**QËLLIMI 2:**  
**RRITJA E**  
**GATISHMËRISË**  
**OPERACIONALE**  
**PËR PROCES TË**  
**KOMPENZIMIT**  
**EFEKTIV DHE**  
**TË SHPEJTË**

---

## Qëllimi 2: Rritja e gatishmërisë operacionale për proces të kompenzimit efektiv dhe të shpejtë

FSDK synim kryesor të saj do të ketë forcimin e gatishmërisë operacionale në përmbushjen e mandatit të saj, kompenzimin efektiv dhe në kohë të depozitorëve të siguar në rast të ngjarjes së siguar. Në funksion të këtij qëllimi, me frekuencë vjetore do të kryhen testime të sistemit me të gjitha Bankat Anëtare, organizimi i simulimeve vjetore të ngjarjes së siguar dhe testimi i bashkëpunimit me Bankën Agjente.

### Objektivi: Testimi vjetor i Sistemit të Kompenzimit të Depozitorëve (SKD)

FSDK do të kryejë testimin e Sistemit për Kompenzimin e Depozitorëve (SKD) me të gjitha Bankat Anëtare së paku një herë në vit, ku do të testohet aftësia e tyre për gatishmërinë e raportimit të saktë të të dhënave mbi depozitorët në sistem, brenda afatit kohor të përcaktuar me Rregullën përkatëse.

Rezultatet nga testimet e SKD-së do të shërbejnë për përmirësimin e cilësisë së të dhënave të raportuara nga bankat anëtare duke siguruar mbajtjen e të dhënave sipas akteve nënligjore të FSDK-së për procesin e kompenzimit dhe korrigjimin e llojeve të gabimeve që mund të identifikohen.

### Objektivi: Organizimi i ushtrimit të simulimit të ngjarjes së siguar

FSDK do të organizojë në baza të rregullta ushtrimet e simulimit të ngjarjes së siguar përmes së cilave synon të testojë dhe masë gatishmërinë e saj operacionale për ekzekutimin efektiv të kompensimit të depozitorëve duke testuar proceset, procedurat, gatishmërinë e stafit dhe qëndrueshmërinë e sistemeve teknologjike dhe ofruesve të shërbimeve të jashtme si dhe Bankën Agjente të Pagesave dhe subjektet tjera mbështetëse të jashtme të përfshirë në një ngjarje të siguar.

Organizimi i simulimeve të ngjarjes së siguar ka për qëllim lehtësimin e organizimit dhe koordinimin e aktiviteteve në procesin e kompenzimit të depozitorëve në ngjarjen e siguar, ku do të simulohen kushte të ngjashme me ato që mund të krijohen në rrethana të caktuara në një ngjarje të siguar.

### Objektivi: Testimi i bashkëpunimit me Bankën Agjente

Brenda vitit 2025, parashikohet të përmyllen procedurat për përzgjedhjen e Bankës/ve Agjente për Pagesë (BAP) me të cilat do të nënshkruhen kontratat në pritje (stand-by) për ofrimin e shërbimit për kompenzimin e depozitorëve të siguar, për tre vitet në vijim në rast të ngjarjes së siguar dhe simulim të saj. Do të kryhet trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve të bankave agjente mbi procesin e kompenzimit, si dhe ushtrimet e simulimit që do të përqendrohen në përdorimin e modulit të veçantë në SKD nga zyrtarët e Bankës Agjente për ekzekutimin e pagesave të kompenzimit. Këto ushtrime kanë për qëllim përmirësimin e kapaciteteve operacionale të Bankës Agjente për procesimin të kompenzimit të depozitave në rast të ngjarjes së siguar.

### Objektivi: Zhvillimi i programeve të stres testeve në përputhshmëri me udhëzimet dhe indikatorët e Autoritetit Bankar Evropian (EBA)

FSDK synon të organizojë ushtrimet e simulimit të ngjarjes së siguar bazuar në udhëzimet e Autoritetit Evropian Bankar (EBA) mbi stres testet për Skemat e Sigurimit të Depozitave (SSD) që synim kryesor kanë vlerësimin e gatishmërisë operacionale të siguresit të depozitave për të kryer në mënyrë efektive dhe të shpejtë kompenzimin e depozitorëve duke u fokusuar në aspekte kritike si kualiteti i të dhënave, burimet e qëndrueshme të financimit, proceset e brendshme operacionale, teknologjia dhe kapacitetet njerëzore.

FSDK do të standardizojë procedurat e brendshme të ushtrimeve të simulimit bazuar në këto udhëzime duke përfshirë metodologjinë, fazat kryesore, indikatorët dhe raportimin e rezultateve me anë të një modeli raportimi të dedikuar. Për këtë arsye Rregulla e brendshme për testimin e SKD dhe ushtrimeve të simulimit do të amandamentohet për t'ju përshtatur këtyre ndryshimeve.

Përafrimi i ushtrimeve të simulimit me udhëzimet e EBA-së mbi stres testet për Skemat e Sigurimit të Depozitave (SSD), ka për qëllim për të përmirësuar kapacitetet institucionale për të kompenzuar shpejt dhe saktë depozitorët e siguar në rastin e një ngjarje të siguar.

### Objektivi: Digjitalizimi i metodës së pagesës për të lehtësuar kompenzimin më të shpejtë të depozitave të siguruara

FSDK synon të implementojë një sistemin digjital të pagesave për kompensimin të shpejtë të depozitorëve të siguruara. Sistemi digjital i pagesave planifikohet të zhvillohet në atë mënyrë që të mbështes transferimin elektronik të shumës së kompensimit të depozitarëve të siguar, e në anën tjetër Banka Agjente për Pagesë (BAP), të mbetet si opsion i përhershëm për tërheqje dhe në rast të parashtimit të reklamacioneve.

Përafrimi me praktikën më të mira ndërkombëtare lidhur me automatizimin e procesit të pagesave përmes transferimit elektronik për depozitorët e siguar në rast të ngjarjes së siguar, do të shpejtonte procesin e kompenzimit dhe njëkohësisht do të kontribuonte në ruajtjen e stabilitetit financiar.

FSDK pas zhvillimit të këtij sistemi do të bëjë rishikimin e kornizës nënligjore të FSDK-së për të përfshirë procesin e kompenzimit përmes metodës online të pagesave duke përfshirë: Rregullën për kompenzimin e depozitorëve të siguar, Procedurën e brendshme mbi veprimin në ngjarjen e siguar, Rregullën për informimin e klientëve dhe materialet informuese të bankave.

**QËLLIMI 3:  
NGRITJA E  
KAPACITETEVE  
NJERËZORE,  
DIGJITALIZIMI DHE  
MODERNIZIMI I  
PROCESEVE**

---

## Qëllimi 3: Ngritja e kapaciteteve njerëzore, digjitalizimi dhe modernizimi i proceseve

### Objekti: Ngritja e kapaciteteve njerëzore

FSDK synon të që në mënyrë të vazhdueshme të bëjë ngritjen e kapaciteteve njerëzore në funksion të rritjes së gatishmërisë operacionale për përmbushjen në mënyrë efektive të mandatit të FSDK-së. Krijimi i ambientit tërheqës dhe stimujve për rekrutimin dhe mbajtjen e talentit të profileve të specializuara për funksionet e FSDK-së.

- Analiza e strukturës organizative, Rregullores për organizimin e brendshëm dhe Politikës së pagave dhe kompenzimit; identifikimin i nevojave institucionale, përgatitjen profesionale, dhe zhvillimin afatgjatë të stafit.
- Përcaktimi i roleve kritike që kërkojnë aftësi dhe përvojë specifike dhe përshtatja me nevojat organizative.
- Hartimi i strategjisë për ngritjen e kapaciteteve njerëzore në funksion të rritjes së gatishmërisë operacionale.
- Angazhimi në bashkëpunime ndërkombëtare në shkëmbim të përvojave dhe praktikave më të mira dhe pjesëmarrja në konferenca dhe seminare e punonjësve si pjesë e zhvillimit profesional.

### Objekti: Digjitalizimi dhe modernizimi i proceseve dhe sistemeve

FSDK gjithashtu synon zhvillimin dhe avancimin teknologjik në funksion të modernizimit dhe digjitalizimit të proceseve të brendshme për rritjen e efikasitetit si dhe menaxhimin e rrezikut.

- Studimi i praktikave më të mira dhe efektive për standardizimin e sistemit për menaxhimin e FSDK.

- Standardizimi i sistemit të raporteve dhe formularëve që gjenerohen nga FSDK, si dhe ndërtimi i një ambienti të përbashkët për menaxhimin e tyre.
- Digjitalizimi dhe modernizimi i proceseve dhe sistemeve.

### Objekti: Siguria kibernetike

Fokus primar do të jetë përmirësimi i sigurisë kibernetike për ruajtjen e sigurt të të dhënave dhe informacionit. FSDK synon të zhvillojë dhe forcojë kornizën ligjore të sigurisë kibernetike me qëllim të mbrojtjes dhe ruajtjes efektive të të dhënave dhe informacionit.

Gjithashtu, FSDK ka për qëllim ngritjen dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës teknike të sigurisë kibernetike, duke siguruar një mbrojtje të qëndrueshme dhe të vazhdueshme për të dhënat dhe informacionet e ruajtura.

- Analiza për zhvillime të mundshme në funksion të përmirësimit të infrastrukturës IT të FSDK-së. Në baza të vazhdueshme do të analizohen mundësitë për zhvillime të mundshme në funksion të përmirësimit të infrastrukturës IT të FSDK-së.
- Hartimi i kornizës ligjore për qeverisjen dhe sigurinë kibernetike mbi mbrojtjen e të dhënave, kontrollin e aksesit, reagimin ndaj incidenteve dhe përdorimin.
- Përditësimi i sistemeve IT për implementimin e zhvillimeve më të fundit.
- Rishikime Periodike të Strategjisë për sigurinë kibernetike
- Përditësimi periodik i politikave për të reflektuar teknologjitë dhe kërcënimet e reja.

FSDK angazhohet të krijojë dhe të forcojë partneritete të qëndrueshme me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, për të zhvilluar praktika të përbashkëta dhe për të shkëmbyer njohuri dhe burime. Ky bashkëpunim është thelbësor për të krijuar një rrjet të gjërë mbështetjeje dhe koordinimi që mundëson reagimin efikas ndaj kërcënimeve kibernetike dhe garantimin e mbrojtjes së të dhënave dhe informacionit.

Përmes forcimit të këtyre raporteve, FSDK synon të kontribuojë në ngritjen e kapaciteteve të përbashkëta dhe të përmirësojë koordinimin për të siguruar një mjedis të sigurt dhe të mbrojtur për të dhënat dhe informacionet ndërkombëtare.



**QËLLIMI 4:**  
**HARMONIZIMI I**  
**LEGJISLACIONIT TË**  
**SIGURIMIT TË**  
**DEPOZITAVE ME**  
**DIREKTIVAT**  
**EVROPIANE**

---

## Qëllimi 4: Harmonizimi i legjislacionit të sigurimit të depozitave me direktivat evropiane

Orientimi strategjik i Republikës së Kosovës mbetet integrimi në Bashkimin Evropian (BE), një proces që kërkon përafrimin dhe harmonizimin e legjislacionit kombëtar me direktivat dhe standardet evropiane.

### Objektivi: Harmonizimi i ligjit të sigurimit të depozitave me direktivat evropiane

FSDK ka për qëllim që Ligji i Sigurimit të Depozitave të përafrohet, sa më shumë që është e mundur, me Direktivën Evropiane për Sigurimin e Depozitave dhe Direktivën Evropiane për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme. Në këtë drejtim, FSDK synon amendamentimin e draftit të Ligjit të ri për Sigurimin e Depozitave dhe dorëzimin e tij Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve duke përfshirë këto propozime kryesore:

- Rritja e limitit të sigurimit të depozitave nga 5,000 euro në 10,000 euro.
- Harmonizimi i dispozitave ligjore me Ligjin e ri për Bankat.
- Përafrimi i mëtejshëm i Ligjit të Sigurimit të Depozitave me kërkesat e Direktivës Evropiane për Sigurimin e Depozitave dhe Direktivës Evropiane për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme.

Këto ndryshime synojnë krijimin e një kuadri ligjor më të fuqishëm dhe të përputhshëm me standardet evropiane, duke kontribuar në stabilitetin e sistemit bankar dhe fuqizimin e besimit publik në institucionet financiare.

### Objektivi: Hartimi dhe plotësimi i legjislacionit sekondar me ligjin e ri të sigurimit të depozitave

FSDK synon të hartojë dhe të përmirësojë legjislacionin sekondar, duke e përshtatur atë me dispozitat e ligjit të ri të sigurimit të depozitave. Ky proces do të përfshijë harmonizimin e akteve nënligjore të FSDK me kërkesat e reja të ligjit të sigurimit të depozitave, si dhe me dispozitat e Ligjit të ri për Bankat. Qëllimi është krijimi i një kuadri ligjor të qëndrueshëm dhe të përputhshëm, i cili do të sigurojë mbrojtje efektive për depozituesit, stabilitet për sistemin financiar dhe përputhshmëri me standardet ndërkombëtare.

### Objektivi: Rishikimi periodik i limitit të sigurimit të depozitave

FSDK synon rishikimin periodik të limitit të sigurimit të depozitave për përafrim gradual me standardet e Bashkimit Evropian për mbrojtje adekuate të depozitorëve.

## QËLLIMI 5: FUQIZIMI I RAPORTEVE NDËRINSTITUCIONALE DHE BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR

## Qëllimi 5: Fuqizimi i raporteve ndërinstitucionale dhe bashkëpunimit ndërkombëtar

### Objektivi: Fuqizimi i raporteve ndërinstitucionale

FSDK synon që fuqizojë raportet ndërinstitucionale me institucionet relevante që të kontribuojë në aranzhimet ndërinstitucionale të mekanizmave të rrjetit të sigurisë financiare.

- Bashkëpunimi me Ministrinë e Financave për fuqizimin politikave publike sa i përket sistemit të sigurimit të depozitave, siç është limiti i sigurimit të depozitave, krijimi i mekanizmave të financimit të jashtëm etj.
- Bashkëpunimi me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës: shkëmbimi efektiv i të dhënave dhe informatave për paralajmërimin e hershëm, procesin e përmbylljes së bankave si dhe avancimet dhe reformat e mëtutjeshme të sistemit të sigurimit të depozitave.
- Bashkëpunimi me Shoqatën e Bankave dhe Bankat Anëtare: Komunikim i vazhdueshëm dhe transparent mbi qëllimet strategjike, iniciativat e reformave të sistemit të sigurimit të depozitave si dhe ndryshimet regullative të cilat i afektojnë bankat anëtare.

### Objektivi: Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar

- Përfaqësimi në asociacionet ndërkombëtare si IADI dhe EFDI:

FSDK synon të ketë përfaqësim gjithëpërfshirës në asociacionet ndërkombëtare profesionale të siguruesve të depozitave si Asociacioni Ndërkombëtar i Siguruesve të Depozitave (IADI) dhe Forumin Evropian të Siguruesve të Depozitave (EFDI).

- Bashkëpunimi bilateral me Agjensionet e Sigurimit të Depozitave

FSDK synon zgjerimin e bashkëpunimit bilateral me Agjencitë e Sigurimit të Depozitave nëpërmes Marrëveshjeve të Mirëkuptimit dhe bashkëpunimit për të përfshirë shkëmbimin e informatave si dhe njohurive mbi çështje të rëndësishme të sigurimit të depozitave me qëllim të fuqizimit të sistemit të sigurimit të depozitave në Republikën e Kosovës.

FSDK angazhohet për fuqizimin e raporteve ndërinstitucionale dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në kontekstin e sistemit të sigurimit të depozitave. Kjo përpjekje ka për qëllim krijimin dhe forcimin e partneriteteve me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare për të siguruar një mbështetje të koordinuar dhe efikase në administrimin dhe mbrojtjen e depozitave të qytetarëve dhe subjekteve ekonomike.

FSDK synon të avancojë shkëmbimin e njohurive, përvojës dhe praktikave më të mira ndërmjet akterëve të ndryshëm, për të siguruar zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe të besueshëm të sigurimit të depozitave. Përmes forcimit të bashkëpunimit me institucionet përkatëse, FSDK do të kontribuojë në përmirësimin e kapaciteteve dhe mekanizmave të mbrojtjes së depozitorëve, duke u siguruar që sistemi i sigurimit të depozitave të funksionojë në përputhje me standardet dhe praktikatat ndërkombëtare.

